



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 766/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 14.11.2018 shqyrtoi ankesat përkatësisht me:

Objekt: Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Sori - Al” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me nr. REF-83297-08-17-2018, me objekt “*Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Spitalin Rajonal Berat*”, me fond limit 3.335.586 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 30.08.2018, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara.

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Alar Food & Service” sh.p.k., në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Ankimues: “Sori – Al” sh.p.k.
Rruga “Beqir Luga”, Pallati Nr.3, Shk. 1/1, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara
Sheshi Skënderbej, Nr. 3, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.

914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 20.08.2018, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF-83297-08-17-2018, me objekt “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Spitalin Rajonal Berat”, me fond limit 3.335.586 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 30.08.2018, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara.

II.2. Në datën 30.08.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3 Nga verifikimi në sitimin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 04.09.2018 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| 1. “Alar Food & Service” sh.p.k. | 2.738.290 lekë, kualifikuar |
| 2. “Sori - Al” sh.p.k. | 3.319.460,43 lekë, skualifikuar |

II.4. Në datën 04.09.2018, operatori ekonomik “Sori - Al” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për vlerësimin e procedurës së prokurimit si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë për arsyet si më poshtë vijon:

“Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar si Kapacitet Teknik, në pikën 4 të seksionit 3.3 të Kriterëve të Vecanta për Kualifikim të DT, sepse nuk arriti të paraqesë një çertifikatë që vërteton menaxhimin për sigurinë ushqimore - analizën e rreziqeve dhe pikat kritike të kontrollit (HACCP) të shoqerisë SORI-AL shpk. Çertifikata e paraqitur N.11928 nuk është lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga një organizëm kombëtar ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë. Subjekti Certiquality s.r.l (Istituto di Certificazione della Qualita, Italy) lëshues i çertifikatës së paraqitur N:11928, nga verifikimet e kryera në zbatim të Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe DPA-së në fuqi nga data 20.03.2018, nuk rezulton i akredituar për certifikimin e menaxhimit të sigurisë ushqimore - analizës së rreziqeve dhe pikave kritike të kontrollit (HACCP). Po ashtu në çertifikatën e lëshuar nuk rezulton kush është organizmi akreditues kombëtar/ndërkombëtar për OVK Certiquality s.r.l Italy. Nga verifikimi i bërë në organizmat akreditues nënshkrues të marrëveshjes së njohjes reciproke me EA, ILAC dhe IAF, sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe DPA-së, nuk rezulton që OVK Certiquality s.r.l të jetë i akredituar nga ndonjë prej tyre për HACCP.”

II.5. Operatori ekonomik “Sori - Al” sh.p.k. në datën 10.09.2018 ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike në procedurën e prokurimit. Gjithashtu, operatori ekonomik ankimes ngre pretendime mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Alar Food & Service” sh.p.k. sipas pretendimeve si më poshtë vijon:

[...] Shoqeria "SORI-AL" shpk ngre pretendimet e saj si me poshte vijon:

1. Skualifikim i padrejte i shoqerise, argumentuar me faktet e meposhtme: Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit zyrtarisht sqaron se skema e HACCP nuk akreditohet. Me shkresen nr 288/1 prot, date 06.09.2018 "Kthim pergjigje Tuajës nr.167, date 06.09.2018, DPA shprehet si me poshte: "Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit ju informon se vete DPA dhe trupat akreditues anetare te EA akreditojne organizmat certifikues te sistemeve te sigurise sipas standartit ISO 22000:2005 dhe jo spas HACCP. Standarti ISO 22000:2005 perfshin kerkesat e skemes HAAÇP..." Na lejoni te sjellim ne vemendjen tuaj se argumentin qe ju perdorni per skualifikimin e shoqerise e bazoni ne Rekomandimin e perbashket te APP-se dhe DPA-se ne fuqi nga data 20.03.2018, nderkohe qe eshte po DPA e cila sqaron se akreditohet ISO 22000:2005 dhe jo skema e HACCP. Nga ana juaj nuk eshte respektuar aspak zbatimi i ketij rekomandimi.

2. Akreditimi i SORI-AL mbi standartin ISO 22000:2005 i cili perfshin edhe skemen e HACCP. Sqarojme se Shoqeria "SORI-AL" sh.p.k certifikohet dhe vleresohet ne menyre periodike nga Shoqeria Italiane "Certiquality" Srl (Istituto di Certificazione della Qualita, Italy), e

akredituar nga Enti Italian i akreditimit ACCREDIA (pale ne Marreveshjet e Njohjes Reciproke EA, IAF dhe ILAC). Certiquality S.r. l, eshte akredituar nder te tjera edhe per certifikimin e sistemit te menaxhimit te sigurise ushqimore ne perputhje me normen UN EN ISO 22000. Kjo norme integron nder te tjera parimet dhe metodat e standartit HACCP. (Duhet te kini parasysh se ISO 22000 eshte standart, ndersa HACCP eshte sistem i perfshire ne kete standart). Skema HACCP (analiza e rreziqeve dhe pika kritike te kontrollit) eshte nje sistem i njohur nderkombetarisht per reduktimin e rreziqeve te sigurise ne ushqim dhe eshte pjese integrale e perfshire ne normen e menaxhimit te sigurise ushqimore UNI EN ISO 22000. Subjektet te cilat imlementojne normen UNI EN ISO 22000 certifikohen njekohesisht edhe me skemen e HACCP. Bazuar ne Rregulloren (CE) Nr. 852/2004 te Palamentit dhe Keshillit European, date 29 Prill 2004, "Per Higjienen e Produkteve Ushqimore", qe nje subjekt te certifikohet per sistemin e menaxhimit te sigurise ushqimore (UNI EN ISO 22000)duhet te aplikojte parimet dhe kerkesat e standartit HACCP si dhe t'i nenshtrohet kontrolleve te tjera shtese. Regjistrimi i sistemit HACCP lidhet ne menyre direkte me kerkesat kyce te Sistemit mbi Menaxhimin e Sigurisë Ushqimore (UNI EN ISO 22000), duke garantuar qe subjektet te cilat e imlementojne kete normë, te operojne njekohesisht, ne menyre efikase sipas rregullave dhe parimeve te miratuara te HACCP. Sipas Udhezimit te Entit Italian te Akreditimit ACCREDIA, organizatat te cilat jane pajisur me certifikatat e akreditimit, mbi sistemin e menaxhimit te sigurise ushqimore, lëshojne së bashku me ISO 22000 dhe certifikaten e standartit HACCP. Ky udhezim percakton se nese organizata e certifikimit eshte e akredituar per te leshuar ISO 22000:2005 ka te drejte te leshoje per llogari te vet edhe certifikaten HACCP qe i bashkelidhet kesaj norme.

3. Kualifikimi i shoqerise "Alar Food Sevice" shpk eshte i parregullt dhe ne shkelje te ligjit duke ju argumentuar si me poshte vijon:

1. Nuk ka paraqitur vertetim debie OSHEE per shlyerjen e detyrimeve te maturuara te energjise (vertetimi i dorezuar eshte per nje tjeter shoqeri). Prandaj ofertuesi nuk ploteson nje nga kriteret e percaktuar ne shkronjen (d) te seksionit 2 Kriteret e Vecanta per Kualifikimit te DST

2. Nuk ka paraqitur dokumentacion qe te provoje se ambienti ku ushtron veprimtarine e sherbimit dhe gatimit te ushqimit, me adrese "Rruga Dytesore Tirane-Durres, Brenda tregut agro-ushqimor ZK 2679, RH52/8, vol.20, fq.136", eshte i pajisur me Aktin Teknik persa i perket masave mbrojtese te zjarrit. Prandaj ofertuesi nuk ploteson nje nga kriteret e percaktuar ne piken 5 te seksionit 3.3 Kapaciteti Teknik, ne Kriteret e Vecanta per Kualifikimi te DST

3. Nuk ka paraqitur dokumentacion qe te provoje se te punesuarit (mercollog/kuzhinier/ndihmes-kuzhinier) jane te pajisur me libreze shendetsore te vlefshme. Prandaj ofertuesi nuk ploteson nje nga kriteret e percaktuar ne piken 8 te seksionit 3.3 Kapaciteti Teknik, ne Kriteret e Vecanta per Kualifikim te DST.

4. Bazuar ne te dhenat e Qendres Kombetare te Biznesit, poseduesi i kuotave te shoqerise "Alar Food Service" sh.p.k. ka lidhur Kontrate Pengu nr. 2650 rep, nr. 1184 kol, date 23.06.2015 mbi kuotat e pjesmarrjes ne shoqeri me Raiffeisen Bank ne permbushje te detyrimeve te Kontrates se Kredise Bankare nr. 2648 rep, nr. 1182 kol, date 23.06.2015. Vendosja e kuotave te kapitalit te shoqerise si garanci per zbatimin e kontrates se kredise bankare, cenon sigurine e subjektit (operatori ekonomik) per te ofruar qendrueshmeri dhe vijimesi ne permbushjen e objektit te kontrates me Autoritetin Kontraktor, ne rastin e shpalljes fitues.

Mungesa e ketyre elementeve thelbesore ne dokumentacionin e paraqitur nga shoqeria "Alar Food Service" sh.p.k. si bashkim operatoresh, duhe ti miaftonte Komisionit te Vleresim

Ofertave per skualifikimin e ketij operatori. Sa me siper, kerkojme nga ana juaj kualifikimin e shoqerise "SORI-AL" shpk në këtë procedure prokurimi dhe skualifikimin e shoqerise "Alar Food Service" sh.p.k.

II.6. Referuar ankesës së operatorit ekonomik ankimues pranë KPP, ky i fundit pretendon se ka marrë dijëni në lidhje me kthimin e përgjigjes se autoritetit kontraktor në datën 13.09.2018. Ndërkohë që, referuar dokumentacionit bashkëlidhur ankesës së operatorit ekonomik ankimues si dhe informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, ky i fundit me anë të shkresës nr.866/1 datë 11.09.2018, i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik ankimues, duke e refuzuar atë. Ndër të tjera, autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes argumenton si më poshtë vijon:

[...] Komisioni per Shqyrtimin e Ankesave pasi ka shqyrtuar te gjithë dokumentacionin e nevojshem ka vleresuar per kete pike si me poshte: Operatori ekonomik e bazon argumentin e ankeses se tij, ne deduksionin subjektiv se operatorete te cilet implementojne normen UNI EN ISO 22000, certifikohen njekohesisht dhe apriori dhe per certifikaten HACCP, duke cituar Rregulloren (CE) N. 852/2004 te Parlamentit te KeshillitEuropian, date 29 prill 2004, "Per Higjiene e Produkteve Ushqimore", qe nje subjekt të certifikohet per sistemin e menaxhimit te sigurise ushqimore (UNI EN ISO 22000) duhet te aplikojë parimet dhe kerkesat e standartit HACCP si dhe ti nenshtrohet kontroleve te tjera shtese. Gjykohet se ky interpretim nuk mund te gjeje baze, nisur nga vet Rregulloren (CE) N 852/2004 e permendur nga operatori ankimues, sipas se ciles theksohet se certifikatat HACCP dhe ISO 22000 ndjekin te njejtat parime, por ato nuk jane zevendesuese te njera-tjetres. Referuar dhe ne shkresen me nr. 288/1, date 06.08.2018 te Drejtorise se Pergjithshme te Akreditimit citohet se Iso 22000:2005 dhe HACCP jane dy standarde te ndryshme, te sistemeve te sigurise ushqimore, pavaresisht kerkesave te perbashketa qe i karakterizon. Gjithashtu evidentohet dhe theksohet se kriteret e vecanta te kualifikimit te percaktuara ne DST, jane kriteret te detyrueshme per tu plotesuar nga operatore ekonomike pjesemarrës ne tender, ne menyre kumulative dhe jo alternative. Permbushja e njerit prej tyre nuk mund te nenkuptoje permbushjen e tjetrit dhe mosplotesimi i qofte dhe vetem njerit prej tyre, perben shkak te mjaftueshem per s'kualifikim. Mungesa e certifikates HACCP per rastin ne fjale perligj skualifikimin e operatorit ekonomik ankimues.

Pretendon te padrejte kualifikimin e operatorit "Alar Food Service" sh.p.k. per asyet [...]. Komisioni per Shqyrtimin e Ankesave pasi ka shqyrtuar te gjithë dokumentacionin e nevojshem ka vleresuar per kete pike si me poshte: Pretendimi i ngritur ne piken 2.1 se ofertuesi nuk ka paraqitur vertetim debie OSHEE per shlyerjen e detyrimeve te energjise dhe se vertetimi i dorezuar eshte per nje tjetër kompani, nuk eshte i bazar ne fakte pasi ofertuesi ka dorezuar ne sistemin elektronik te prokurimit, nje kontrate qiraje midis "Alar Food Service" sh.p.k. dhe "Ekma Albania" sh.p.k. ku vertetohet lidhja midis tyre dhe si rrjedhoje vertetimi i dorezuar eshte i vlefshem.

Pretendimi i ngritur ne piken 2.2 se ofertuesi nuk eshte i pajisur me Aktin Teknik per sa i perket masave mbrojtese te zjarrit, nuk eshte i bazuar pasi nga verifikimi i dokumenteve te dorezuara nga ofertuesi ne sistemin elektronik te prokurimeve vertetohet pajisja me kete Akt Teknik sipas kerkesave te DST.

Pretendimi i ngritur ne piken 2.3 se ofertuesi nuk ka paraqitur dokumentacionin qe te provoje se te punesuarit (mercollog/kuzhiniere/ndihmes-kuzhiniere) jane te pajisur me libreza shendetesore nuk qendron, pasi ne baze te verifikimit te dokumenteve te dorezuar nga ofertuesi ne sistemin

elektronik te prokurimit rezulton se librezat shendetesore per te punesuarit e mesiperm jane dorezuar sipas kerkesave te DST.

Pretendimi i ngritur ne pikën 2.4 se ofertuesi nuk ka sigurine per te ofruar qendrueshmeri dhe vijimesi nuk eshte i bazuar, pasi operatori "Alar Food Service" sh.p.k. i ka plotesuar te gjitha kerkesat e percaktuara ne DST me qellim garantimin dhe sigurimin e realizimit te kontrates.

Bazuar ne gjithë me siper, eshte vendosur se skualifikimi i shoqerise "SORI-AL" sh.p.k. dhe kualifikimi i shoqerise "Alar Food Service" sh.p.k., jane bere ne perputhje me kerkesat e Ligjit 9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar.

II.7. Në datën 19.09.2018 operatori ekonomik "Sori - Al" sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke ngritur të njëjtat pretendime si në ankesën e ngritur pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr. 934/1 prot., datë 27.09.2018, protokolluar me tonën në datën 28.09.2018, me objekt "Dërgim dokumentacioni për procedurën e prokurimit me objekt "Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Spitalin Rajonal Berat" është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik "Sori - Al" sh.p.k. se arsyeja e skualifikimit "[...]Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar si Kapacitet Teknik, në pikën 4 të seksionit 3.3 të Kriterëve të Vecanta për Kualifikim të DT, sepse nuk arriti të paraqesë një certifikatë që vërteton menaxhimin për sigurinë ushqimore - analizën e rreziqeve dhe pikat kritike të kontrollit (HACCP) të shoqerisë SORI-AL shpk. Certifikata e paraqitur N.11928 nuk është lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga një organizëm kombëtar ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë. Subjekti Certiquality s.r.l (Istituto di Certificazione della Qualita, Italy) lëshues i certifikatës së paraqitur N:11928, nga verifikimet e kryera në zbatim të Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe DPA-së në fuqi nga data 20.03.2018, nuk rezulton i akredituar për certifikimin e menaxhimit të sigurisë ushqimore - analizës së rreziqeve dhe pikave kritike të kontrollit (HACCP). Po ashtu në certifikatën e lëshuar nuk rezulton kush është organizmi akreditues kombëtar/ndërkombëtar për OVK Certiquality s.r.l Italy. Nga verifikimi i bërë në organizmat akreditues nënshkrues të marrëveshjes së njohjes reciproke me EA, ILAC dhe IAF, sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe DPA-së, nuk rezulton që OVK Certiquality s.r.l të jetë i akredituar nga ndonjë prej tyre për HACCP", nuk qwndron, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 7 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 3.2. “Kapaciteti teknik”, pika 2; 3; 4; nga autoriteti kontraktor është përcaktuar:

2-Operatori ekonomik duhet të paraqesë një certifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shoqërisë, ISO 9001-2008/ ISO 9001-2015. Certifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.

3-Certifikatë e shoqërisë ISO 22000:2005/ ISO 22000:2018 - Sistemet e menaxhimit të sigurisë ushqimore. Certifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.

4-Certifikatë e menaxhimit për sigurinë ushqimore - Analiza e rreziqeve dhe pikat kritike të kontrollit (HACCP). Certifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik ankimes, rezulton se është paraqitur, në përmbushje të kriterit të sipërcituar:

- Certifikatë Nr.11927, lëshuar nga "Certiquality", konform normës UNI EN ISO 9001 :2015, për aktivitetet si më poshtë : Administrim mense: Përgatitja, shpërndarja dhe dhënia e vakteve. Shërbim pastrimi dhe higjienizimi. Kujdesi dhe mirëmbajtja e ambienteve të gjëlberëta.
- Certifikatë Nr.15273, lëshuar nga "Certiquality", konform normës UNI EN ISO 22000:2005 Cat G, për aktivitetet si më poshtë: Administrim mense: Përgatitja, shpërndarja dhe dhënia e vakteve.
- Certifikatë Nr.11928, "Si certifica che il sistema di gestione per l'autocontrollo igienico (HACCP)", lëshuar nga "Certiquality", konform dokumentave UNI 10854:WHO/FNU/FOS/93.3(ALINORM93/13A) - ALLEGATO A CAC/RCP 1-1969, REV.4(2003), për këto aktivitete: Administrim mense: Përgatitja, shpërndarja dhe dhënia e vakteve.

III.1.3. Operatori ekonomik ankimes pretendon: “Shoqeria “SORI-AL” shpk ngre pretendimet e saj si me poshte vijon: 1. Skualifikim i padrejte i shoqërisë, argumentuar me faktet e mëposhtme: Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit zyrtarisht sqaron se skema e HACCP nuk akreditohet. Me shkresen nr 288/1 prot, date 06.09.2018 "Kthim pergjigje Tuajës nr.167, date 06.09.2018, DPA shprehet si me poshte: "Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ju informon se vete DPA dhe trupat akreditues anetare te EA akreditojne organizmat certifikues te sistemeve te sigurise sipas standartit ISO 22000:2005 dhe jo spas HACCP. Standarti ISO 22000:2005 perfshin kerkesat e skemes HAAÇP...” Na lejoni te sjellim ne vemendjen tuaj se argumentin qe ju perdorni per skualifikimin e shoqërisë e bazoni ne Rekomandimin e perbashket te APP-se dhe DPA-se ne fuqi nga data 20.03.2018, nderkohe qe eshte po DPA e cila sqaron se akreditohet ISO 22000:2005 dhe jo skema e HACCP. Nga ana juaj nuk eshte respektuar aspak zbatimi i ketij rekomandimi.

2. Akreditimi i SORI-AL mbi standartin ISO 22000:2005 i cili perfshin edhe skemen e HACCP. Sqarojme se Shoqeria "SORI-AL" sh.p.k certifikohet dhe vleresohet ne menyre periodike nga Shoqeria Italiane "Certiquality" Srl (Istituto di Certificazione della Qualita, Italy), e akredituar nga Enti Italian i akreditimit ACCREDIA (pale ne Marreveshjet e Njohjes Reciproke EA, IAF dhe ILAC). Certiquality S.r. l, eshte akredituar nder te tjera edhe per certifikimin e

sistemit te menaxhimit te sigurise ushqimore ne perputhje me normen UNI EN ISO 22000. Kjo norme integron nder te tjera parimet dhe metodat e standartit HACCP. (Duhet te kini parasysh se ISO 22000 eshte standart, ndersa HACCP eshte sistem i perfshire ne kete standart). Skema HACCP (analiza e rreziqeve dhe pika kritike te kontrollit) eshte nje sistem i njohur nderkombetarisht per reduktimin e rreziqeve te sigurise ne ushqim dhe eshte pjese integrale e perfshire ne normen e menaxhimit te sigurise ushqimore UNI EN ISO 22000. Subjektet te cilat imlementojne normen UNI EN ISO 22000 certifikohen njekohesisht edhe me skemen e HACCP. Bazuar ne Rregulloren (CE) Nr. 852/2004 te Palamentit dhe Keshillit European, date 29 Prill 2004, "Per Higjienen e Produkteve Ushqimore", qe nje subjekt te certifikohet per sistemin e menaxhimit te sigurise ushqimore (UNI EN ISO 22000)duhet te aplikojte parimet dhe kerkesat e standartit HACCP si dhe t'i nenshtrohet kontrolleve te tjera shtese. Regjistrimi i sistemit HACCP lidhet ne menyre direkte me kerkesat kyce te Sistemit mbi Menaxhimin e Sigurise Ushqimore (UNI EN ISO 22000), duke garantuar qe subjektet te cilat e imlementojne kete norme, te operojne njekohesisht, ne menyre efikase sipas rregullave dhe parimeve te miratuara te HACCP. Sipas Udhezimit te Entit Italian te Akreditimit ACCREDIA, organizatat te cilat jane pajisur me certifikatat e akreditimit, mbi sistemin e menaxhimit te sigurise ushqimore, lëshojne së bashku me ISO 22000 dhe certifikaten e standartit HACCP. Ky udhezim percakton se nese organizata e certifikimit eshte e akredituar per te leshuar ISO 22000:2005 ka te drejte te leshoje per llogari te vet edhe certifikaten HACCP qe i bashkelidhet kesaj norme."

III.1.4. Autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes drejtuar operatorit ekonomik ankimues argumenton se: "Komisioni per Shqyrtimin e Ankesave pasi ka shqyrtuar te gjithë dokumentacionin e nevojshem ka vleresuar per kete pike si me poshte: Operatori ekonomik e bazon argumentin e ankeses se tij, ne deduksionin subjektiv se operoret te cilet imlementojne normen UNI EN ISO 22000, certifikohen njekohesisht dhe apriori dhe per certifikaten HACCP, duke cituar Rregulloren (CE) N. 852/2004 te Parlamentit te Keshillit European, date 29 prill 2004, "Per Higjienen e Produkteve Ushqimore", qe nje subjekt të certifikohet per sistemin e menaxhimit te sigurise ushqimore (UNI EN ISO 22000) duhet te aplikojte parimet dhe kerkesat e standartit HACCP si dhe ti nenshtrohet kontrolleve te tjera shtese. Gjykohet se ky interpretim nuk mund te gjeje baze, nisur nga vet Rregulloren (CE) N 852/2004 e permendur nga operatori ankimues, sipas se ciles theksohet se certifikatat HACCP dhe ISO 22000 ndjekin te njejtat parime, por ato nuk jane zevendesuese te njera-tjetres. Referuar dhe ne shkresen me nr. 288/1, date 06.08.2018 te Drejtorise se Pergjithshme te Akreditimit citohet se ISO 22000:2005 dhe HACCP jane dy standarde te ndryshme, te sistemeve te sigurise ushqimore, pavaresisht kerkesave te perbashketa qe i karakterizon. Gjithashtu evidentohet dhe theksohet se kriteret e vecanta te kualifikimit te percaktuara ne DST, jane kriteret te detyrueshme per tu plotesuar nga operoret ekonomike pjesemarrës ne tender, ne menyre kumulative dhe jo alternative. Permbushja e njerit prej tyre nuk mund te nenkuptoje permbushjen e tjetrit dhe mosplotesimi i qofte dhe vetem njerit prej tyre, perben shkak te mjaftueshem per s'kualifikim. Mungesa e certifikates HACCP per rastin ne fjale perligj skualifikimin e operatorit ekonomik ankimues."

III.1.5. Në nenin nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet se: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese".

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... .”

III.1.6. Në nenin 30 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se: “Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit”.

Çertifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit”.

III.1.7. Në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, është publikuar rekomandimi mbi hartimin e kërkesave të cilësisë i nënshkruar ndërmjet Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, datë 20.03.2018 (data e protokollimit pranë APP), shoqëruar me Manualin teknik “Mbi mënyrën e marrjes së informacionit për organet e vlerësimit të konformitetit të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit/organizma akreditues të huaj, të cilët kanë nënshkruar marrëveshjen e reciprocitetit me Republikën e Shqipërisë”.

Në këtë rekomandim, është përcaktuar: “Të gjitha certifikatat e cilësisë, të cilat vlerësohen të nevojshme të kërkojnë nga autoriteti kontraktor, duhet të jenë të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilët janë të akredituara nga DPA, ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë”.

Gjithashtu, në manualin teknik, përcaktohen mënyrat, se si merret informacioni për organet e vlerësimit të konformitetit të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit/organizma akreditues të huaj, të cilët kanë nënshkruar marrëveshjen e reciprocitetit me Republikën e Shqipërisë.

Në këtë manual janë të përcaktuara detajet në lidhje me organet e vlerësimit të konformitetit (OVK), organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, mënyrën se si mund të merret informacioni nëse një OVK është i akredituar apo jo nga DPA, mënyrën se si mund të merret informacion nëse certifikata apo raporti i lëshuar nga OVK e akredituar është aktualisht i vlefshëm, si mund të merret informacion nëse një OVK është akredituar nga organizma akreditues të huaj, mënyrën si mund të gjendet që një OVK është e akredituar nga një organizëm akreditues dhe cila është fusha e akreditimit. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor, i cili sqaron se, ka kryer verifikimet përkatëse në lidhje me certifikatat e paraqitura nga operatori ekonomik ankimues, si edhe nga verifikimi i kryer, bazuar në këtë manual në faqet zyrtare të organeve që kanë lëshuar certifikatën N.11928 në drejtim të shoqërisë “Sori - AI” sh.p.k. rezulton se, ky i fundit ka mangësi në dokumentacionin e paraqitur prej tij në këtë procedurë prokurimi në sistemin e prokurimeve elektronike.

Ashtu siç edhe autoriteti kontraktor informon, konstatohet se shoqëria “Sori - AI” sh.p.k. është pajisur me certifikatën N.11928 “Si certifica che il sistema di gestione per l’autocontrollo igienico (HACCP)”, lëshuar nga subjekti “Certiquality”. Nga verifikimi, referuar edhe manualit teknik, sipas të cilit DPA njeh të barazvlefshëm certifikata akreditimi të lëshuara nga organet akredituese që kanë nënshkruar marrëveshje të njohjes reciproke, rezulton se subjekti “Certiquality” nuk është

i akredituar për të lëshuar certifikata HACCP. Gjithashtu, referuar këtij dokumenti të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, konstatohet se kjo certifikatë e lëshuar nga “Certiquality” nuk është e akredituar nga asnjë organizëm kombëtar dhe ndërkombëtar.

III.1.8. Sa më sipër, KPP sqaron se, mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme.

Operatori ekonomik ankimues duhej të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

III.1.9. Akoma më tej, për sa i përket pretendimit të operatorit ekonomik ankimues se *“Akreditimi i “Sori – Al” mbi standartin ISO 22000:2005, i cili përfshin edhe skemen e HACCP. Certiquality S.r. l, është akredituar ndër të tjera edhe për certifikimin e sistemit të menaxhimit të sigurisë ushqimore në përputhje me normen UN EN ISO 22000. Kjo norme integron ndër të tjera parimet dhe metodat e standartit HACCP”*, KPP sqaron se, në momentin e dorëzimit të dokumentacionit për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi, vetë operatori ekonomik ankimues, për të përmbushur kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor për sa i përket certifikatës HACCP, ka dorëzuar një dokument me titullin “Certifikatw” (si mw lart përmendur) të lëshuar nga subjekti “Certiquality”, pra vetë operatori ekonomik ankimues e pranon faktin që ekziston një certifikatë e tillë dhe e ka paraqitur në sistem për të përmbushur kërkesën e autoritetit kontraktor, dhe në momentin që u njoh me arsyet e skualifikimit, ka ngritur pretendimin se ky kriter duhet të konsiderohet i plotësuar vetëm me paraqitjen e certifikatës ISO 22000:2005, pasi kjo e fundit përfshin HACCP. Pra, vlen të sqarohet se, mungesa fizike e këtij dokumenti, nuk ka ardhur për shkak të paqartësisë së kriterit, por është ngritur si pretendim, vetëm pasi operatori ekonomik ankimues është njohur me arsyet e skualifikimit të ofertës së tij.

III.1.10. K.P.P. gjykon se në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor për paraqitjen e certifikatës HACCP, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar parashikohet se *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankimi në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”*. Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të

ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “ [...] *Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”.*

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Sori - AI” sh.p.k. për skualifikimin e operatorit ekonomik “Alar Food & Services” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se:

III.2.1. Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), me titull “Të drejtat e personit të interesuar” parashikon se: “*Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.*”

III.2.2. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të paraqesë (argumentojë) se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjisllacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP është i papranueshëm.

Neni 63, pika 1 kërkon shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor.

Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës.

Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real (përkundrejt atij imagjinar) nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Në rastin konkret, KPP sqaron se, referuar arsytimit të mësipërm në pikën III.1. të këtij vendimi, duke qenë se gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “Sori - AI” sh.p.k. mbetet e skualifikuar, rrjedhimisht ky operator ekonomik nuk legjitimohet të paraqesë ankesë për operatorët e tjerë ekonomikë, për sa kohë rezulton i skualifikuar nga procedura e mësipërme e prokurimit.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Sori - AI” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me nr. REF-83297-08-17-2018, me objekt “*Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Spitalin Rajonal Berat*”, me fond limit 3.335.586 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 30.08.2018, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1509 Protokolli

Datë 19.09.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Enkeleda Bega	Vilma Zhupaj	Lindita Skeja	Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha